REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK
OZ/Nr. Prot. 2-18/1638
Nr. i fax.
Data 06/03/2026

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK– MUNICIPALITY OF JUNIK

Kuvendi i Komunës
Nr. 002/17
Datë: 27.02.2026

Kuvendi i Komunës së Junikut në mbledhjen e dytë të rregullt të mbajtur më datë 27.02.2026, pas shqyrtimit të propozimit për themelimin e Komitetit për Arsim, Shkencë, Kulturë Rini dhe Sport, propozim i shqyrtuar dhe miratuar për rekomandim në mbledhjen e parë të rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa të datës 18.02.2026, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (d), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (c), nenin 51, paragrafi 51.2, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 13, paragrafi 1 dhe 3, nenin 14 dhe nenin 15, të Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2020, për procedurat e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve tjera në Komunë, nenin 21, shkronja (h), nenin 22, paragrafi 22.1, pika 4, nenin 39, nën-paragrafi 39.1 të Statutit të Komunës së Junikut, miratuar më datë 29.09.2010, nenin 72, pika 1, 3, nenin 74, pika 1, 2, nenin 75, pika 1, 2 ,3 të Rregullores për punën e Kuvendit të Komunës Junik, miratuar më datë 31.10.2018, nxjerr këtë:

VENDIM

për themelimin e Komitetit për Arsim, Shkencë, Kulturë, Rini dhe Sport

1.Për themelimin e Komitetit për Arsim, Shkencë, Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Junikut, në përbërje prej pesë anëtarëve si vijon:

1. Përfaqësuesi i Lidhjes Demokratike të Kosovës, anëtar i Kuvendit të Komunës;
2. Aldi Gacaferi - Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, anëtar i Kuvendit të Komunës;
3. Elsa Hima - Lëvizja VETËVENDOSJE!, anëtare e Kuvendit të Komunës;
4. Dritë Krasniqi - anëtare jashtë Kuvendit të Komunës dhe
5. Drite Salihi Hoxha - anëtare jashtë Kuvendit të Komunës.

2.Detyrat dhe përgjegjësitë e Komitetit për Arsim, Shkencë, Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Junikut, janë të definuara në nenin 16, 17 dhe 18 të UA (MPL) NR. 05/2020, për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në komunë.

3.Kryesuesi i Komitetit për Arsim, Shkencë, Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Junikut zgjidhet nga anëtarët e komitetit.

4.Mandati i anëtarëve të Komitetit për Arsim, Shkencë, Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Junikut është i njëjtë me mandatin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës.

6.Raportimi për punën e tyre është raportim vjetor në Kuvendin e Komunës, kurse kompensimi i anëtareve të komitetit, bëhet nga buxheti i komunës për gjashtë (6) mbledhje në vit, sipas nenit 15, pika 3, të Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2020, për procedurat e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve tjera në Komunë.

4.Ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës së Junikut.

Akti i dorëzohet:

1. Kryetarit të Komunës;
2. Kryesuesit të Kuvendit të Komunës;
3. Anëtarëve të Komitetit për ASKRS,
4. Drejtorisë për Buxhet dhe Financa;
5. Udhëheqësit të Personelit dhe
6. Arkivit.

Kryesuesi i Kuvendit
z.Leonard Lloluni